



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 21 maj 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: prill, 2021

- **Paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})**, në prill të vitit 2021, u ul me 0,1%, në bazë mujore, e cila është kryesisht rezultat i uljes së depozitave pa afat³, dhe në një masë më të vogël për shkak të depozitave afatgjate deri në dy vjet, në kushte të rritjes në komponentët tjerë. Krahasuar në bazë vjetore, paraja e gjerë është rritur me 8,5% kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave pa afat, me një ndikim pozitiv edhe të depozitave afatshkurtra dhe parave të gatshme në qarkullim, në mes të një rënieje në depozitat afatgjata deri në dy vjet.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive^{4,5} të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	3.2021	4.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	3.2021	4.2021	3.2021	4.2021
Парична маса M4	455,834	468,912	469,050	486,989	491,717	491,007	8.9	9.8	6.9	6.9	7.9	7.1	0.7	-0.1
Парична маса M3	403,714	416,935	418,556	436,231	441,478	441,230	8.3	9.7	7.6	8.0	9.4	8.5	0.9	-0.1
<i>од кои:</i>														
Готови пари во оптек	37,891	41,125	41,667	43,701	43,350	44,424	21.3	26.3	24.9	21.0	14.4	9.4	0.1	2.5
Вкупни депозити	409,200	418,916	418,644	434,915	439,343	437,357	8.3	8.4	6.1	5.9	7.4	6.9	0.7	-0.5
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	108,138	110,550	112,505	123,212	122,085	120,973	12.5	11.2	8.0	10.1	12.9	14.3	1.7	-0.9
Во денари	75,876	77,609	79,641	86,323	85,618	81,951	13.8	9.3	5.4	5.4	12.8	11.1	3.3	-4.3
Во странска valuta	32,261	32,941	32,865	36,889	36,467	39,022	9.5	15.9	14.9	22.8	13.0	21.8	-2.0	7.0
Домаќинства	275,574	280,512	278,469	285,216	289,941	290,432	8.6	8.7	6.1	4.6	5.2	4.7	0.2	0.2
Во денари	147,532	149,204	145,806	150,991	152,839	152,984	11.9	10.1	6.2	3.3	3.6	3.4	-0.2	0.1
Во странска valuta	128,042	131,309	132,663	134,225	137,102	137,448	5.1	7.1	6.0	6.2	7.1	6.3	0.6	0.3
Вкупни кредити	343,702	352,718	352,824	357,296	361,561	364,194	5.8	6.6	7.3	4.7	5.2	5.7	0.9	0.7
<i>од кои:</i>														
Корпоративен сектор	167,654	172,978	168,086	169,826	171,117	172,529	1.8	4.6	5.2	1.1	2.1	2.3	0.7	0.8
Во денари	103,597	106,688	101,925	102,688	103,024	105,634	0.4	3.3	2.7	-0.9	-0.6	2.0	0.1	2.5
Во странска valuta	64,057	66,290	66,161	67,138	68,093	66,895	4.0	6.9	9.3	4.3	6.3	2.8	1.5	-1.8
Домаќинства	174,634	178,384	183,431	185,814	188,697	189,907	10.1	8.8	9.5	8.0	8.1	8.9	1.0	0.6
Во денари	96,643	99,469	103,939	105,049	106,994	107,349	8.8	8.7	12.0	10.5	10.7	11.4	1.1	0.3
Во странска valuta	77,990	78,916	79,492	80,765	81,703	82,558	11.9	8.9	6.4	5.0	4.8	5.7	0.9	1.0

Burimi: BPRMV.

¹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për parane e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_monetarna_07_2018_mak.pdf

³Paratë e depozitave i referohen llogarive rrjedhëse në banka dhe shtëpi kursimesh dhe llogarive rrjedhëse të institucionet tjera financiare në Bankën Popullore



⁴Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 këndejan nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit.

⁵Të dhënat për agregatet monetare, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Në prill, **totali i depozitave**⁶, shënoi një rënie prej 0,5%, si rezultat i rënies së depozitave të sektorit të korporatave, në kushte të rritjes së moderuar të depozitave të amvisërive. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, totali i depozitave është për 6,9% më i lartë, me një rritje të depozitave në të dy sektorët, që është më e shprehur në sektorin e korporatave.
- **Totali i kredive**⁷, shënoi një rritje mujore prej 0,7% këtë muaj, gjatë një kreditimi të rritur në të dy sektorët, me një kontribut të madh të sektorit të korporatave. Norma vjetore e rritjes arriti 5,7% dhe rrjedh nga kreditimi më i madhe në të dy sektorët, i cila është më e shprehur në sektorin e amvisërive.



Burimi: BPRMV.

1. Depozitat dhe kreditë e sektorit të korporatave⁸



Burimi: BPRMV.

⁶Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4.

⁷ Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t'i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndeje këto krahasime janë ndërprerë.

⁸Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin korporatat publike dhe private jofinanciare.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Totali i depozitave të sektorit të korporatave** shënoi një rënie për 0,9% në bazë mujore gjatë prillit. Rënia është kryesisht për shkak të uljes së depozitave pa afat dhe në masë më të vogël për shkak të depozitave afatgjata në denarë, në mes të një rritjeje të komponentëve tjerë. Analizuar në bazë vjetore, depozitat e sektorit të korporatave u rritën me 14,3%, kryesisht si rezultat i depozitave të rritura pa afat, me një kontribut pozitiv shtesë edhe të depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në valutë të huaj, në mes të një rënieje në komponentët tjerë.
- Në prill, **kreditë e sektorit të korporatave**⁹, u rritën me 0,8% në bazë mujore, plotësisht për shkak të kreditimit të rritur në denarë, në kushte të rritjes së kredive të miratuar në valutë të huaj. Rritja vjetore prej 2,3% është për shkak të rritjes së kredive në denarë dhe valutë të huaj, me një pjesëmarrje më të shprehur të kredive në denarë.



Burimi: BPRMV.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive¹⁰



Burimi: BPRMV.

- **Totali i depozitave të amvisërive**, në prill, shënoi rritje tremujore dhe vjetore prej 0,2% dhe 4,7%, përkatësisht. Ndryshimi në rritje në të dyja bazat shpjegohet me rritje e

⁹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.



¹⁰Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

depozitave pa afat dhe depozitave në valutë të huaj, në kushte të një rënieje në komponentët tjerë.

- Në prill, **kreditë e amvisërive**, u rritën me 0,6% në bazë mujore dhe 8,9% në bazë vjetore. Në bazë mujore, kreditimi i amvisërive në valutë të huaj është më i lartë se kreditimi në monedhë vendase, ndërsa në bazë vjetore, kontributi i kreditimit në denarë është dukshëm më i lartë në raport me kreditimin në valutë të huaj.



Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.

Tabela 2. Kredi të bankave dhe shtëpive të kursimeve të dhëna personave fizikë, sipas qëllimit



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

	состојба (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	3.2021	4.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	3.2021	4.2021	3.2021	4.2021
Потрошувачки кредити	93,440	94,982	97,850	98,772	99,721	100,620	13.5	10.0	9.9	6.9	6.7	7.7	1.1	0.9
Станбени кредити	52,959	54,392	55,985	58,306	59,901	60,702	13.9	13.8	14.0	13.6	13.1	14.1	1.1	1.3
Автомобилски кредити	306	292	291	282	263	259	-4.1	-8.6	-7.9	-10.9	-14.0	-14.5	-1.5	-1.7
Кредитни картички	11,570	11,508	11,649	11,205	10,539	10,417	-4.5	-4.2	-2.6	-6.1	-8.9	-8.1	-1.0	-1.2
Негативни салда по тековни сметки	6,499	6,205	6,280	5,818	6,399	6,093	-4.8	-9.4	-10.8	-5.0	-1.5	0.6	2.3	-4.8
Други кредити	3,969	3,946	3,912	3,871	3,736	3,711	-6.7	-6.4	-6.7	-6.0	-5.8	-6.6	-0.7	-0.7

Burimi: BPRMV.

- Në prill, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, **kreditë konsumatore dhe banesore**, si kategori më të përfaqësuara shënojnë një rritje mujore prej 0,9% dhe 1,3%, përkatësisht, gjatë një rritjeje vjetore prej 7,7% dhe 14,1%, përkatësisht. **Kreditë për automjete** u ulën në bazë mujore dhe vjetore me 1,7% dhe 14.5%, përkatësisht. Kreditë e miratuara në **kartat e kreditit**, këtë muaj u ulen për 1,2% në bazë mujore dhe 8,1% në bazë vjetore. Në prill, **saldot negative të llogarive rrjedhëse** janë ulur me 4.8% në bazë mujore, gjatë një rritjeje vjetore prej 0,6%. Kreditë e miratuara në **baza tjera**, në prill, kanë shënuar një rënie mujore dhe vjetore prej 0,7% dhe 6,6%, përkatësisht.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Bilance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nspk

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: 21 qershor i vitit 2021 (mesatare referuese, maji i vitit 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).